

**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“HIDROIZOLIME EDA” SH.P.K.**

HYRJE

Sot në datën 21.07.2023 sipas Aktit të themelimit në cilësinë e ortakëve themelues po formulojmë këtë status të Shqoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “**HIDROIZOLIME EDA**” sh.p.k në mbështetje të Nenit 230 të ligjit nr 9901 datë 14/04/2008, “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar. Aktiviteti i shoqërisë do të zhvillohet duke u mbështetur në dispozitat e këtij Statusi.

KREU I

**THEMELIMI, EMRI, FORMA, ZYRA QENDRORE, OBJEKTI I VEPRIMTARISË,
KOHËZGJATJA, PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE , PERSONALITETI JURIDIK**

NENI 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më datë 21.07.2023 themeluestit kane krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“HIDROIZOLIME EDA” SH.P.K**

Emertimi i shoqerise ndiqetnga akronimi “SH.P.K”, sipas kerkesave te të ligjit nr 9901 datë 14/04/2008, “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

THEMELUESIT:


Z. Endrit BREÇANI i datelindjes 22/05/1985, lindur ne Bajram Curri, Tropoje, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar me dokument identifikues leternjoftim Nr. personal I80522070G.

Z. Dardan ZOGJANI i datelindjes 05/04/1982, lindur ne Prishtine dhe banues ne Kosove , madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar me dokument identifikues leternjoftim Nr. personal 1001064017.

Z. Artan QERIQI i datelindjes 05/04/1990, lindur ne Connecticut USA, banues ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar me dokument identifikues pasaporte Nr.578282891.

Ndryshimi i emrit te shoqerise mund te behet vetem me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Shoqeria ka vulen perkatese, te cilat vendosen ne fund te cdo dokumenti.

DARDAN ZOGJANI


ARTAN QERIQI


Endrit Breçani


NENI 2

Forma

Shoqeria tregtare “**HIDROIZOLIME EDA**” sh.p.k ka formen e nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar, themeluar dhe organizuar ne perputhje e dispozitat e ligjit nr 9901 datë 14/04/2008, “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut.

NENI 3

Zyra Qendrore

Shoqeria tregtare “**HIDROIZOLIME EDA**” sh.p.k do te kete zyren qendrore ne adresen:

“Njesia administrative Kashar, Ish Fusha e Sportit Mezes, Tirane”.

Ndryshimi i zyres qendrore mund te behet vetem me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Administratori mund te hape dhe mbylle dege ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise , te cilat do te ushtrojne veprimtarine sipas kompetencave dhe kufizimeve te vendosura nga Ortaket dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 4

Objekti Veprimitarise

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “**HIDROIZOLIME EDA**” sh.p.k do të zhvillojë aktivitet me objekt:

- Tregtim te gjitha materialeve ndertimore,
- Marrje persiper e punimeve te gjithave materialeve ndertimore,
- Shitje me shumice dhe me pakice te materialeve qe shoqeria tregon
- Blerje dhe shitje te pronave te paluajtshme dhe pronave te luajtshme.

DARDAN ZOGJANI ARTAN QERIQI
Bogdani Amin

Eduard Brezani

Shoqeria mund te kryeje te gjitha aktivitetet e dobishme dhe/ose te nevojshme te lejuara nga legjislacioni ne fuqi, per realizimin e objektit te veprimitarise se shoqerise

Objekti i veprimitarise te shoqerise mund te ndryshohet, perditesohet, plotesohet ne cdo moment me vendim te Ortakeve.

NENI 5

Kohezgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pa përcaktuar duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB)

Ajo do të drejtohet nga **Administratori Z. Endrit Breçani**, shtetas shqiptare banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote Juridike per te vepruar, i datëlindjes 22.05.1985, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë, mbajtes i dokumentit te identifikimit karte identiteti Nr.I80522070G

Shoqëria mund të prishet ose të pushojë aktivitetin e saj me një vendim të Asamblesë së Përgjithëshme të ortakëve, në bazë të lëgjislacionit Shqiptar dhe statutit të shoqërisë.

NENI 6

Ortaket

Ortaket e shoqerise jane **Z. Endrit BREÇANI, Z. Dardan ZOGJANI, Z. Artan QERIQI**.

Ortaket nuk perjigjen per detyrimet e shoqerise "**HIDROIZOLIME EDA**" sh.p.k dhe mbulojne personalisht hunjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkuara prej tyre

NENI 7

Personaliteti Juridik

Shoqeria fiton personalitet juridik pasi te jete regjistruar ne QKB , ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne ligj.

Shoqeria pasi te kte fituara personalitetin juridik eshte perjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimitarise se saj.

DARDAN ZOGJANI
D. Zogjani

ARTAN QERIQI
A. Qeriqi

Endrit Breçani
E. Breçani

KREU II
**KAPITALI DHE KUOTATA, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT, KALIMI I
KUOTAVE TE KAPITALIT**

NENI 8

Kapitali themeltar dhe kuotat

Kapitali themeltar fillestari shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë i ndarë me 3 (tre) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Endrit BREÇANI**, Zoterues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000,00 (pesedhjete mijë) Lekë që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Z. Dardan ZOGJANI** Zoterues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 25,000.00 (njezete e pese mijë) Lekë që përben 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Z. Artan QERIQI** Zoterues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 25,000.00 (njezete e pese mijë) Lekë që përben 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 9

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ne cdo kohe , ne perputhje me legjislacionin ne fuqi , me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve .

Shoqeria ne cdo kohe mund te zvogeloje kapitalin me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Ne cdo rast kapitali nuk mund te zvogelohet nen minimumin e vleres se kapitalit te kerkuar nga legjislacioni ne fuqi per shoqerite tregtare.Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Kontributi i metejsphem i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme/kuota ose te drejta) . Menyra e shlyerjes se kontributeve do te percaktohet me vendim te .Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

DARDAN ZOGJANI
Ilojja e mu

ARTAN QERIQI
Afher.

Endrit Breçani
E

NENI 10

Kalimi i kuotave te kapitalit

Kuotat e kapitalit tē një shoqërie me përgjegjësi tē kufizuar e tē drejtat që rrjedhin prej tyre mund tē fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër tē parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht tē transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht tē transferueshme me rrugë trashëgimie.

Kuotata e kapitalit mund tu kalohen teresisht ose pjeserisht te treteve qe nuk bejne pjese ne shoqeri pa asnje kufizim apo kusht.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 11

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare tē shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe tē ekspertëve kontabël tē autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” tē kësaj pike;

DARDAN ZOGJAVI
Dardan Zogjavi

ARTAN PERIQI
Artan Periqi

Endi Bresani
Endi Bresani

- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- largimin dhe perjashtimin e ortakut
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 12

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Mbledhja e Asamblese se pergjithshme mund te mbahet ne seline e shoqerise , ne video-konference ose ne një vend tjeter te percaktuar me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

DARDAN ZOGJANI
Dardan Zogjani

ARTAN REPIQI
Artan Repiqi

Endrit Brugoni

NENI 13

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

NENI 14

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

DARDAN ZOGJANI
Drogjani

ARTAN REPIĆ
Alia-

Endi Bregani

NENI 15

Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- dhënen ose jo tëpër fitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtusi dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 16

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë , pa kufizim ne lidhje me shtetsine si administratorët e shoqërisë.

Administratori eshte organi ekzekutiv i shoqerise. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratori mund te heqë dore ne cdo kohe nga detyra e tij nepermjet , një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblese se përgjithshme te Ortakeve , te cilet duhet te caktojne një administrator te ri.

Doreheqja e administratorit nuk cenon padite e shoqerise per shkelje te detyrimit te besnikerise qe administratori ka ndaj saj , sipas legjisacionit te zbatueshem.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorët e një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Të dhënat e identifikimit te administratorit :

Z. Endrit Breçani, shtetas shqiptare banues ne Tirane, madhor me zotesi te plete Juridike per te vepruar, i datëlindjes 22.05.1985, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë, mbajtes i dokumentit te identifikimit karte identiteti Nr.I80522070G

DADM ZOGJANI
Dzogjani

ARTAN QERIEV
Arun

Endrit Breçani
E

NENI 17

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët jane perjegjes per administrimin e shoqerise dhe perfaqesojne shoqerine me pale te treta , ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti, vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve dhe legjislacionin e zbatueshem.

Administratoret kanë të drejtë e detyrohen të:

- kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojnë shoqërinë tregtare me palet e treta
- kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme pë rmiratim;
- krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në raste kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

DARDAN ZOGJANI
Dajacimi.

ARTAN QERIQI
Almira.

Enver Bresani

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 18

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdus;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë tërregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

DARDAN ZOGJANI
Dardan Zogjani

ARTAN QERIQI
Artan Qeriqi

Enver Bresani
Enver Bresani

- c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin finanziar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR ,SHPERNDARJA E FITIMIVE , EKSPERTI

NENI 19

Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurise se veprimtarise dhe raporti i ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

NENI 20

Eksperet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

DARDAN ZOGJAVI
Dajani

ARTIAN QERIQI
Alimi

Endri Breguni

KREU V
PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 21

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar l apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 22
Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, nëpërputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 23

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

DARDAN ZOGJANI
Dardan Zogjani

ARTAN QERIQI
Artan Qeriqi

Endri Bregumi
Endri Bregumi


NENI 24

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKET THEMELUES


Z. ENDRIT BREÇANI



Z.DARDAN ZOGJANI


DARDAN ZOGJANI

Z. ARTAN QERIQI


ARTAN QERIQI